

Fletë udhëzuese mbi rregullat aktuale të karantinës në lidhje me infeksionet e Covid 19 nga 23 prill 2021

Rregullorja e re e karantinës në lidhje me infeksionet Covid-19 është në fuqi në Nordrhein-Westfalen që nga 23 prilli 2021. Pastaj, janë valide rregullat e mëposhtme:

1. Si duhet të silleni nëse keni simptomat e sëmundjes

Nëse për arsye se testi i shpejtë, apo vetë-testi i juaj rezultoi pozitiv ose për shkak të simptomeve të sëmundjes si për shembull, dhimbjes së fytit, kollës, rrjedhjes së hundës, temperaturës ose barkqitjes, keni kryer (PCR- Test in) ju jeni të detyruar ligjërisht që derisa të ju vie rezultati, të qëndroni në karantinë shtëpiake. Një urdhëresë me shkrim ose telefon lidhur me këtë nga Departamenti i shëndetësisë nuk do të pranoni.

2. Rezultati pozitiv i testit

Në rast të një rezultati pozitiv të testit, ju qëndroni në karantinë dhe menjëherë njoftoni njerëzit me të cilët keni pasur kontakt personal në katër ditët para testit ose në kohën që nga kryerja e testit. Kjo vlen veçanërisht nëse distanca prej 1.5 metrash nuk ka mundur të mbahet ose nëse keni qenë së bashku për një kohë të gjatë në një dhomë të pa ajrosur ose të ajrosur dobët.

Mjeku ose qendra testuese automatikisht përcjell rezultatin pozitiv të testit në departamentin e shëndetit. Nga atje do të thirreni pasi të jetë në dispozicion rezultati pozitiv i testit. Meqenëse është mëse e nevojshme që të ndiqen kontaktet e pasura sa më shpejt që të jetë e mundur, do të ishte shumë e dobishme sikur të kishit krijuar tashmë një listë të emrave dhe numrave të telefonit celular të personave me të cilët keni kontaktuar më parë, e të cilat të dhëna më pas do t'ia kaloni departamentit të shëndetësisë.

Periudha e karantinës për një test pozitiv është 14 ditë pas kryerjes së testit. Nuk ju lejohej të largoheni nga banesa juaj përgjatë kësaj kohe. Për këtë qëllim, Qyteti i Bielefeld it kryen kontrolle-rasti. Shkeljet e rregullit të karantinës mund të dënohen me një gjobë deri në 25,000 euro.

Një Vendim-karantine me shkrim nga departamenti i shëndetësisë nuk do ta merrni më, prandaj, ju lutemi, informoni punëdhënësin tuaj për datën e testit tuaj pozitiv në mënyrë që të ju kompenzohen shpenzimet nga shoqata rajonale.

Pak para përfundimit të periudhës së karantinës, do të merrni një telefonatë tjetër nga departamenti i shëndetësisë. Ju do të pyeteni nëse vazhdoni të keni simptoma të sëmundjes ose nëse ka pasur përmirësime të qëndrueshme. Nëse keni ende simptoma të sëmundjes, karantina do të zgjatet në konsultim me departamentin e shëndetit derisa të mos keni më simptoma për 48 orë me radhë.

3. Anëtarët që bashketojnë dhe personat e kontaktit

Një periudhë karantine 14 ditore vlenë gjithashtu për anëtarët që bashketojnë dhe kontaktet e ngushta të një personi që rezultoi pozitiv. Pasi të dihet rezultati i testit, anëtarët duhet të hyjnë në karantinë menjëherë. Periudha e karantinës 14 ditore fillon në ditën kur personi testohet pozitiv. Edhe anëtarët që bashketojnë, gjithashtu nuk marrin më një Vendim- karantine me shkrim nga departamenti i shëndetësisë. Prandaj, ju lutemi informoni punëdhënësin e tij për datën e testit të anëtarit që bashkëton, që ka rezultuar pozitiv në mënyrë që ti kompenzohen shpenzimet nga shoqata rajonale.

Për personat e tjerë të kontaktit, koha e karantinës llogaritet pas kontaktit të fundit me personin që ka rezultuar pozitiv. Periudhën e saktë do ta mësoni në rastin tuaj personal kur departamenti i shëndetësisë ju telefonon. Për këtë grup do të lëshohet një Vendim-karantine me shkrim nga departamenti i shëndetësisë.

Në mënyrë që të përjashtohet mundësia e infeksionit me koronavirus, në fund të periudhës së karantinës duhet të kryhet një test. Ju do të merrni informacion në lidhje me kohën e testit dhe regjistrimit kur të kontaktoni departamentin e shëndetit. Nëse testi është negativ, karantina përfundon pas ditës së 14-të. Në këtë rast, Departamenti i shëndetësisë nuk do t'ju telefonojë.

Për një përjashtim nga detyrimi i karantinës për personat e kontaktit të personit të infektuar që ka rezultuar pozitivë dhe të cilët tashmë konsiderohen të mbrojtur ose që mund të sigurojnë prova se janë të mbrojtur plotësishtë me vaksinë kundër Covid-19, do të vendosë Departamenti i shëndetësisë.

Nëse keni ndonjë pyetje, ju lutemi kontaktoni linjën telefonike të qytetit për Corona (Corona- Hotline): 51 2000, nga e hëna deri të premten nga ora 8 deri në orën 18.